

 REPUBLIKA E KOSOVËS - REPUBLIKA KOSOVA KOMUNA E FUSHË-KOSOVËS - OPŠTINA KOSOVO POLJE DREJTORIA E ADMINISTRATËS - DIREKCIJA ZA ADMINISTRACIJU		
Nr.faq/Br.str.		161
Datë/Datum.		17.09.2018
KOMUNA E FUSHË-KOSOVËS - OPŠTINA KOSOVO POLJE		



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA
REPUBLIC OF KOSOVA

KOMUNA E FUSHË-KOSOVËS / OPŠTINA KOSOVO-POLJE
MUNICIPALITY OF FUSHË-KOSOVË, KOSOVO POLJE



Ekstrakt nga procesverbali, mbledhja e gjashtë VI-të, e rregullt e Kuvendit të Komunës, e mbajtur më datë 28.06.2018, ora 10:00h, në Sallën e Kuvendit të Komunës.

Prezentë në mbledhje ishin anëtarët e Kuvendit të Komunës: Vjollca Konjusha – Kryesuese e Kuvendit të Komunës, Remzi Shala, Ilir Hasani, Arjeta Jashari, Mirvete Gërguri, Jetmir Berisha, Albert Jasharaj, Miranda Shabani, Sabit Bullatovci, Shaban Ademi, Sabri Rexhepi, Ali Zogiani, Naser Graiçevci, Aida Alimi, Migjen Kolshi, Arjana Zogiani, Mehdi Lahu, Durim Hajra, Eglantina Azemi, Doruntina Jashari, Driton Ademi, Betim Ahmeti, Ali Ismaili, Driton Hasolli, Qerim Gara, Bashkim Krasniqi dhe Ljubisa Qirkoviq.

Kryetari i Komunës dhe Drejtorët e Drejtorive të Komunës: Fadil Krasniqi - Nënkyetar i Komunës, Halil Qerimi - Nënkyetar i Komunës për Komunitete, Nuriye Fazliu - Drejtore e Administratës, Ramadan Jashanica - Drejtor i Financave dhe Buxhetit, Jakup Tërrnava - Drejtor i Gjeodezisë, Kadastrit dhe Pronës, Nuriye Avdiu - Drejtore e Kulturës, Rinisë dhe Sportit, Jakup Dumani - Drejtor i Shëndetësisë dhe Mirëqenies Sociale, Maliq Berisha - Drejtor i Shërbimeve Publike dhe Mjedisit, Ekrem Berjani - Drejtor i Zhvillimit Ekonomik dhe Mehmet Gërguri - Drejtor i Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural.

Të tjerë: Përfaqësuesit e OSBE-së, KFOR-it dhe qytetarë.

Kryesuesja e Kuvendit të Komunës përshëndeti të pranishmit në mbledhje, pas verifikimit të prezencës së anëtarëve të Kuvendit të Komunës, konstatoi se ekziston kuorumi për mbajtjen e mbledhjes dhe prezantoi këtë:

REND DITE

1. Pyetje dhe përgjigje parlamentare.
2. Propozim për shqyrtimin e Kornizës Afatmesme Buxhetore 2019-2021.
3. Propozim për lejimin e shfrytëzimit të mjeteve financiare për zhvillimin e mësimi joformal.
4. Propozim për riorganizimin e mësimi në shkollat fillore në Fushë-Kosovë.
5. Të ndryshme.

Kryesuesja e Kuvendit të Komunës përshëndeti të pranishmit në mbledhje, konstatoi se ekziston kuorumi i mbledhjes, më pas lexoi pikat e rendit të ditës dhe ftoi anëtarët që të deklarohen rreth rendit të ditës pastaj hapi diskutimin.

Ali Ismaili: Përshëndes të pranishmit në mbledhje. Unë dua të tërheq një paralele, njëherë i kemi njëzet e dy pika të rendit të ditës, herën tjetër tri pika, kjo nuk është e arsyeshme.

Pasi që diskutime tjera nuk pati, Kryesuesja e Kuvendit të Komunës ftoi anëtarët e Kuvendit të Komunës që të votojnë për aprovimin rendit të ditës së propozuar për këtë mbledhje.

U votua me: njëzet e gjashtë vota 'për', një 'kundër' dhe asnjë abstenim, gjithsej njëzet e shtatë anëtarë të pranishëm.

Në bazë të votimit, Kryesuesja e Kuvendit të Komunës konstatoi se Kuvendi i Komunës, me shumicë të votave, e aprovoi për shqyrtim rendin e ditës së propozuar.

Pika e parë (1) - Pyetje dhe përgjigje parlamentare.

Kryesuesja e Kuvendit të Komunës: E kemi pikën 'Pyetje dhe Përgjigje Parlamentare', ftoj anëtarët e Kuvendit të Komunës që të ngritin ndonjë çështje për diskutim nëse kanë, ndërsa Ekzekutivin e Komunës të përgjigjet në pyetjet e anëtarëve të Kuvendit në mbledhje, apo me shkrim në mbledhjen e ardhshme.

Durim Hajra: Përshëndes të pranishmit në mbledhje. Unë i kam dy pyetje për Drejtorinë e Shërbimeve Publike, pyes, a parashihet të bëhet ndriçimi publik në Rrugën 'Pajazit Islami' në lagjen e 'Dardanisë', ndërsa për Drejtorinë e Planifikimit Urban pyes, a planifikon të asfaltojë rrugën në gjatësi prej 200 metra te 'Kalaja e Harilaçit'?

Eglantina Azemi: Përshëndes të pranishmit në mbledhje. Rruga '2 Korriku' në lagjen 'Dardania' është e pakalueshme, pyes, a mund të planifikohet që me rishikimin e buxhetit kjo rrugë të rregullohet, së paku me zhavorr, si një zgjidhje e përkohshme për qytetarët?

Doruntina Jashari: Përshëndes të pranishmit në mbledhje. Banorët e fshatit Henc kanë nevojë që të rregullohet një gropë septike në lagjen 'Mjeku', sepse aty me rastin e reshjeve kemi kthimin e ujërave të zeza dhe kontaminimin e ujit të puseve, andaj kërkojmë nga Drejtoria e Planifikimit Urban që të ndaj mjetet për rregullimin e rrjetit të kanalizimit për ta bërë zgjidhjen e këtij problemi për qytetarët.

Shaban Ademi: Përshëndes të pranishmit në mbledhje. Unë do ta vendos në funksion aparaturën time meqë nuk kemi publikim të audioincizimeve. Po ashtu kërkoj nga Kryesuesja e Kuvendit që të kërkojë praninë e mediave në mbledhjen e Kuvendit ose të tregojë qëndrimin e saj, apo është marionetë e Kuvendit, sepse në asamblenë tonë nuk duhet të vazhdojë ky terr informativ! Ju duhet ta tregoni legjitimitetin tuaj, edhe si Lidhje Demokratike e Kosovës, e të mos shndërroheni në problem që e drejton Ekzekutivi i Komunës, sepse kjo është e turpshme. Për Drejtorinë e Urbanizmit, në lagjen e 'Graiçevcve' janë hapur gropat dhe aty po punohet jashtëligjshëm, këtë nuk e them unë por e thotë ligji. Këtë punë e ka ndaluar edhe Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor, aty po punohet me një Pëlqim të jashtëligjshëm, Drejtori i Planifikimit Urban është i prirë për manipulime! Unë pyes, cila do të jetë data valide për këto objekte, ajo e legalizimit të tyre apo e dhënies së lejes, sepse njëjtë ka ndodhur edhe në të kaluarën me rastin e ngritjes së objekteve të Latif Kryeziut, në dalje të fshatit Sllatinë e Madhe në vitin 2011, së pari atje është punuar pastaj është dorëzuar për vendimmarrje në Kuvend propozimi për këto objekte?! Njësoj veprohet edhe me shtruarjen e rrugëve me zhavorr në vende ku ende nuk ka shtëpi afër njëra tjetrës. Kjo metodë e punës është e papranueshme, kështu veprohet edhe me trotuare dhe asfalt ku punojnë nga dy punëtorë me një karrocë, këto punë e kanë cilësinë e dobët dhe është marri të punohet kështu! Në Fushë-Kosovë, në Rrugën 'Nënë Tereza', ka uzurpim të hapësirave publike, është formuar një Komision për lirim të tyre i cili e anashkalon Drejtorinë e Inspektoratit, në këtë rast është krijuar një anarki e plotë ku nuk ka veprime institucionale! Oborri i Qendrës Kryesore të Mjekësisë Familjare është shndërruar në parking të automjeteve! Ne kërkojmë që të mbyllet dera e hyrjes nga objekti shëndetësor në komunë sepse aty nuk po dihet kush janë pacientët dhe kush personat privat! Po ashtu, për shumë muaj, në objektin tonë shëndetësor, nuk ka mundësi të kryhet as pasqyra e gjakut! Problemet atje në të kaluarën janë ngritur me të drejtë nga anëtarja e Kuvendit,

znj. Fazile Sejdiu, sepse tani nga Shefi i Grupit Parlamentar të Lidhjes Demokratike të Kosovës dhe Kryeshefi i institucionit shëndetësor që e mban këtë pozitë, pa të drejtë ligjore, nuk interesohet për mbarëvajtjen dhe interesat e qytetarëve për ofrimin e shërbimeve shëndetësore por për interesat e tij për asfaltim, e çështje tjera! Për këtë unë kam argumente dhe fakte të cilat do t'i paraqes në vazhdimësi.

Nënkryetari Komunës: Përshëndes të pranishmit në mbledhje. Ne më herët i kemi marrë dy vendime për caktimin e lokacionit për ndërtimin e objektit për Degën e Gjykatës Themelore në Fushë-Kosovë dhe Qendrës së Regjistrimit Civil, mirëpo hapësira aty është e vogël. Tani në Zyrën e Kryetarit të Komunës është Kryetari i Këshillit Gjyqësor të Kosovës. Ne kërkojmë që kjo hapësirë të ndahet e tëra për Këshillin Gjyqësor të Kosovës, i cili do ta ndërtojë objektin e Gjykatës në Komunën tonë, andaj kërkojmë nga Kuvendi i Komunës që të marr një vendim për këtë çështje. Sa i përket përgjigjeve për çështjet e ngritura nga anëtarët e Kuvendit rregullimi i rrugëve me zhavorr mund të bëhet, ndërsa çështja e dhënies së Pëlqimeve për ndërtim, unë mendoj se është e njohur për drejtorin, i cili vepron në bazë të kompetencave dhe autorizimeve që i ka.

Shaban Ademi: Unë këto shqetësime dhe probleme do t'i paraqes tërë kohën, madje edhe në shtyp siç është rasti për të gjeturat e Auditorit të Jashtëm të cilat janë paraqitur edhe në 'Kohën Ditore', mirëpo nuk ka asnjë veprim apo përmirësim. Unë nuk kam problem me ju si njeri por me institucionin dhe veprimet e paligjshme që po bëhen.

Kryesuesja e Kuvendit të Komunës: Ju po e tregoni kulturën tuaj, unë e kam krenarinë time. Ju duhet t'i falënderoheni që jeni këtu Lidhjes Demokratike të Kosovës, Kryetarit të Komunës, z. Burim Berisha dhe z. Abdullah Prebreza që ju kanë pranuar në listën tonë. Unë kam qenë bartëse e listës dhe tani jam Kryesuese, sepse Lidhja Demokratike e Kosovës nuk tradhton.

Remzi Shala: Unë nuk kam problem personal me askënd. Në shëndetësi jam në Këshillin Drejtues, kërkesat për furnizim me material i kemi bërë por ne nuk mund t'ia ndalim të drejtën e ankesës askujt në procedurën e prokurimit. Ndërgjegjen për investimet publike në fshatin Henc e kam të pastër sepse nuk kemi bërë asnjë ndasi në baza partiake.

Driton Ademi: Përshëndes të pranishmit në mbledhje. Në aspektin formal, ju i nderuari përfaqësues i komuniteteve, nuk duhet të uleni aty në përbërjen e kryesisë së mbledhjes, sepse konfirmimi i dorëheqjeve bëhet vetëm nga Komisioni Qendror Zgjedhor. Përveç juve, Nënkryetari i Komunës edhe Drejtori i Planifikimit Urban po flasin këtu në emër të subjektit politik, kjo nuk duhet të ndodhë dhe ju duhet të kërkonit falje para institucionit më të lartë të Komunës! Pyes, nga Drejtoria e Shërbimeve Publike, a do të bëhet dezinfektimi i terrenit para stinës së verës? Drejtorinë e Inspektoratit e pyes, në kohën kur janë duke u zhvilluar ndërtimet pa leje, aktualisht, në sa prej tyre veprohet me Pëlqime dhe pa leje ndërtimore? Pyetja e tretë është për Kryetarin e Komunës, a është duke u punuar në bazë të Planit Vjetor të Punës, vizionit dhe strategjisë, apo në mënyrë të shpërndarë 'ad hoc' dorëzohen çështjet për shqyrtim në asamblenë komunale? Dhe pyetja e katërt, a janë duke u zbatuar rekomandimet e Planit për Auditivin e Brendshëm, dhe pse nuk janë përcjellë ato për shqyrtim dhe analizim në asamblenë komunale?

Aida Alimi: Përshëndes të pranishmit në mbledhje. Pyes, pse nuk rregullohet çështja e audioincizimit dhe kërkoj që materiali zyrtar të na dorëzohet i kompletuar dhe në formë elektronike, në mënyrë që të evitohen problemet dhe të jemi të informuar me kohë?

Driton Hasolli: Përshëndes të pranishmit në mbledhje. Propozoj që nxënësve nga fshati Bardh i Madh dhe Graboc i Poshtëm t'iu zbritet bileta, nga 50 cent në 30 cent, në vitin e ardhshëm shkollor.

Betim Ahmeti: Përshëndes të pranishmit në mbledhje. Ju informoj se nga tani e tutje unë më nuk e përfaqësoj Aleancën për Ardhmërinë e Kosovës por do të jem përfaqësues i Lidhjes Demokratike të Kosovës.

Mehdi Lahu: Përshëndes të pranishmit në mbledhje. Unë i kam dy pyetje, së pari, a do të bëhet dezinfektimi i terrenit për t'u mbrojtur nga mushkonjat dhe e dyta, në bazë të Planit Rregullues, a parashihet të zhvendoset tregu nga lokacioni ku bëhet tani e të rregullohet një treg sipas standardeve, sepse tregu aktual nuk i plotëson as kushtet minimale?

Drejtori i Inspektoratit: Përshëndes të pranishmit në mbledhje. Ju informoj se në lagjen e 'Graiçevcëve' është duke u punuar dhe ka një Pëlqim për zhvillimin e punimeve. Ka tejkalime në ndërtime. Ne si Drejtori e Inspektoratit i ndalim punimet madje edhe disa herë radhazi dhe lëndën e dërgojmë në procedurë gjyqësore, kjo punë është në kompetencën tonë të veprimit si institucion.

Ali Ismaili: Përshëndes të pranishmit në mbledhje. Ne e kemi të qartë se lëndët dorëzohen në procedurën gjyqësore, por çdo tejkalim duhet të ndërpritet me kohë nga Drejtoria e Inspektoratit dhe të rriten kapacitetet individuale e jo me projektin e KARITAS-it të merren punëtorët në shërbime ku nuk ka nevojë, siç është Zyra e Gjendjes Civile, apo edhe ndonjë vend tjetër me punë administrative! Në rastet më të rënda duhet të veprojë Prokuroria e Shtetit sepse Komuna e Fushë-Kosovës është shndërruar në një katrahurë, sa i përket ndërtimeve. Drejtoria e Planifikimit Urban duhet të punojë në bazë të ligjit e jo të jap Pëlqime për ndërtim por të lëshojë Leje Ndërtimore, konform Planeve Urbane dhe Rregulluese.

Drejtori i Shërbimeve Publike dhe Mjedisit: Përshëndes të pranishmit në mbledhje. Sqaroj se kërkesa për dezinfektim nuk është në kompetencën time, por në planifikimet buxhetore, ajo është vendosur në kompetencën e Drejtorisë së Bujqësisë.

Drejtorja e Administratës: Unë dua të jem e sinqertë dhe ju për çdo keqpërdorim nëse keni fakte duhet të lajmëroni prokurorinë. Po ashtu, dua t'ju njoftoj se për mbledhjen e ardhshme do të bëhet vendosja e mobilieve të reja në sallën e Kuvendit.

Ali Ismaili: Drejtoritë komunale që ndajnë subvencione duhet të na dorëzojnë listat e përfituesve në mënyrë që ne ta dimë kush janë përfituesit e bursave në arsim, subvencioneve në shëndetësi, serrave dhe motokultivatorëve në bujqësi! Nga Zyra e Kryetarit të Komunës i kemi mbi 100 mijë euro subvencione dhe ne nuk i dimë emrat e përfituesve të tyre! Unë dhe anëtarët e tjerë të Kuvendit për 5 vite kemi kërkuar që të bëhet publikimi i audioincizimeve, por kjo nuk ka ndodhur! Ne do të jemi të detyruar që të përdorim edhe metoda alternative për shprehjen e qëndrimeve tona publike për çështje të ndryshme në media dhe rrjetet sociale, siç është 'facebooku', meqë i nderuari Nënkryetar i Komunës në këtë drejtim nuk po kemi asnjë lëvizje.

Mirvete Gërguri: Përshëndes të pranishmit në mbledhje. Pyes, a planifikohet të zgjidhet çështja e ujit të pijshëm për banorët e fshatit Bardh i Madh? Kur pritet të asfaltohen rrugët 'Fortesa' dhe 'Kulla' në fshatin Bardh i Madh? Po ashtu dua të përsëris edhe kërkesën e banorëve të fshatit Bardh i Madh për rregullimin e parkut. Kontrata për furnizim me material shëndetësor duhet të jetë kontratë - kornizë, në mënyrë që të mos pësojnë pacientët me rastin e ndërprerjes së kontratave, secila kontratë duhet ta ketë menaxherin e kontratës.

Ilir Hasani: Përshëndes të pranishmit në mbledhje. Kërkoj nga Drejtoria e Shërbimeve Publike dhe Policia e Kosovës që, kohë pas kohe, të dalin në terren tek 'Pishat' në fshatin Sllatinë e Vogël dhe të japin edhe dënime. Po ashtu edhe në afërsi të shkollës së fshatit duhet të vendosen pengesa në rrugë sepse makinat po lëvizin me shpejtësi të madhe.

Drejtori i Arsimit: Listën e subvencioneve të ndara në arsim do ta keni të publikuar në ueb-faqe të Komunës.

Drejtorja e Administratës: Kjo kamerë e vendosur këtu është 3D dhe incizimi përcillet, ndërsa mediat nuk vijnë pa pasur mbulesë financiare.

Ali Ismaili: Ju si Komunë e kryeni obligimin vetëm ndaj Ministrisë së Administrimit të Pushtetit Lokal, e jo ndaj qytetarëve! Ne si subjekte politike, pa përjashtim, përfshirë këtu edhe Lidhjen Demokratike të Kosovës si parti në pushtet, kemi kërkuar që të bëhet publikimi i audioincizimeve. Kjo kërkesë e jona bëhet për pesë vite radhazi dhe kjo që po ndodhë në Kuvendin e Komunës së Fushë-Kosovës është një 'nonsens', sepse ju nuk jeni duke e zbatuar ligjin!

Driton Ademi: Komuna duhet të bëjë zgjidhje alternative për të plotësuar standardet për punë normale të Kuvendit të Komunës. Është e pakuptimtë se si Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal nuk ndërmerr asnjë veprim, edhe pse në vazhdimësi shkelen procedurat, madje këtu e kemi edhe Zëvendësministrin që punon në hierarkinë e kësaj ministrie!

Kryesuesja e Kuvendit të Komunës: Në muajin mars të këtij viti i kemi marrë dy vendime për ndarjen e lokacionit për Degën e Gjykatës Themelore në Fushë-Kosovë dhe Qendrën e Regjistrimit Civil, tani propozimi i Ekzekutivit të Komunës është që kjo parcelë, me sipërfaqe prej 9 ari e 52 metra katrorë, të ndahet vetëm për Gjykatë. Ju ftoj që ta përkrahni për të qenë pjesë e rendit të ditës kjo pikë.

Ali Ismaili: Kjo punë është jashtë procedurës së paraparë meqë ne nuk i kemi as vendimet e kaluara të Kuvendit të Komunës për të analizuar çështjen para procesit të vendimmarrjes.

Nënkryetari i Komunës: Të gjitha vendimet e Kuvendit të Komunës nuk zbatohen sepse ndonjëherë ka pengesa të natyrave të ndryshme, vendimi për ndërtimin e Shkollës Profesionale në fshatin Miradi e Poshtme nuk është pranuar nga donatorët - Komisioni Evropian. Ndërtimi i objektit të Gjykatës e ka rëndësinë e vet për qytetarët e komunës sonë, andaj ju ftoj që ta përkrahni këtë propozim.

Nënkryetari i Komunës: Propozoj që të hyjë në shqyrtim 'Propozimi për ndarjen e lokacionit për ndërtimin e objektit për Degën e Gjykatës Themelore në Fushë-Kosovë'. Kryesuesi i Këshillit Gjyqësor të Kosovës, tani është në takim me Kryetarin e Komunës për këtë çështje, hapja e Gjykatës në komunën tonë është në interesin e qytetarëve.

Kryesuesja e Kuvendit të Komunës: E kemi për shqyrtim, tani, kërkesën e Ekzekutivit të Komunës 'Propozimin për shfuqizimin e dy vendimeve të marra në muajin mars, 2018', njëri për Degën e Gjykatës Themelore në Fushë-Kosovë, në sipërfaqe prej 500m² dhe tjetri për Qendrën e Regjistrimit Civil, në sipërfaqe prej 452m², tani sipërfaqja si tërësi propozohet të ndahet për ndërtimin e objektit për Degën e Gjykatës Themelore në Fushë-Kosovë.

Pas sqarimeve, Kryesuesja e Kuvendit të Komunës e qiti në votim për të hyrë në rendin e ditës për shqyrtim 'Propozimin për ndarjen e lokacionit për ndërtimin e objektit për Degën e Gjykatës Themelore në Fushë-Kosovë'.

U votua me: pesëmbëdhjetë vota 'për', shtatë 'kundër' dhe asnjë abstenim, gjithsej njëzet e dy anëtarë.

Në bazë të votimit, Kryesuesja e Kuvendit të Komunës konstatoi se Kuvendi i Komunës, me shumicë të votave, e aprovoi për shqyrtim 'Propozimin për ndarjen e lokacionit për ndërtimin e

objektit për Degën e Gjykatës Themelore në Fushë-Kosovë dhe shfuqizimin e vendimeve të marra në muajin mars 2018’.

Vendimet e marra në muajin mars 2018 iu shpërndan anëtarëve të Kuvendit të Komunës nga Shërbimi i Kuvendit të Komunës.

Pas sqarimeve, Kryesuesja e Kuvendit të Komunës e qiti në votim për aprovim ‘Propozimin për ndarjen e lokacionit për ndërtimin e objektit për Degën e Gjykatës Themelore në Fushë-Kosovë’. U votua me: shtatëmbëdhjetë vota ‘për’, asnjë ‘kundër’ dhe katër abstenime, gjithsej njëzet e një anëtarë.

Në bazë të votimit, Kryesuesja e Kuvendit të Komunës konstatoi se Kuvendi i Komunës, me shumicë të votave, e aprovoi për shqyrtim ‘Propozimin për ndarjen e lokacionit për ndërtimin e objektit për Degën e Gjykatës Themelore në Fushë-Kosovë dhe shfuqizimin e dy vendimeve të marra në muajin mars 2018’ si dhe mori:

V E N D I M

Për dhënien në shfrytëzim të pronës komunale, në sipërfaqe prej $S=952m^2$, me destimin për ndërtimin e objektit publik për Degën e Gjykatës Themelore në Fushë-Kosovë, nga Këshilli Gjyqësor i Kosovës, në pjesën e Ngastrës Kadastrale Nr. 01209-0 në sipërfaqen e saj të lirë prej $S=952m^2$, e evidentuar në numrin e njësisë kadastrale Nr. 72514036-01209-0, të datës 19.03.2018 në Zonën Kadastrale Fushë-Kosovë, në kuadër të sipërfaqes së tërësishme të pronës komunale prej $S=7366m^2$.

Pika e tretë (3) - Propozim për shqyrtimin e Kornizës Afatmesme Buxhetore 2019-2021.

Kryesuesja e Kuvendit të Komunës: E kemi për shqyrtim ‘Kornizën Afatmesme Buxhetore Komunale 2019-2021’, ku janë përfshirë investimet publike në qytet dhe në secilin fshat të komunës. Ftoj Drejtorin e Financave dhe Buxhetit që të na jap sqarime.

Drejtori i Financave dhe Buxhetit: ‘Kornizën Afatmesme Buxhetore Komunale për vitet 2019-2021’ e kemi shqyrtuar edhe në mbledhjen e Komitetit për Politikë e Financa, ku kemi sqaruar prioritetet e Komunës së Fushë-Kosovës për shpenzime në periudhën 3 vjeçare. Kjo Kornizë është hartuar duke u mbështetur në Strategjinë Komunale për Zhvillim Ekonomik 2016-2020, Qarkoren Buxhetore 2019/1 të Ministrisë së Financave, Qarkoren e Brendshme Buxhetore, të mbështetur në nenin 20 të Ligjit për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësi. Në tabelën e parë e kemi përmbledhjen e financimit komunal për vitet 2018-2021, si komponentë e vlerësimit të hershëm nëpër kategoritë ekonomike, ku janë të shpërndarë grandet qeveritare për Komunitat e Kosovës: grandi i përgjithshëm, grandi specifik për arsim si dhe grandi specifik për shëndetësi. Grandi i përgjithshëm - në tabelën nr. 2 e kemi të zbërthyer shpërndarjen e grandeve dhe të hyrave komunale për periudhën 2019-2021. Grandi i përgjithshëm është në shumë të përgjithshme prej 3,397,977.00€, grandi i arsimit është 4,131,369.00€, grandi i shëndetësisë është 1,044,810.00€, ndërsa të hyrat vetjake janë 2,439,993.00€ dhe huamarrja në shëndetësi është 83,585.00€. Në tabelën nr. 3 i kemi të paraqitura burimet e të hyrave ku grandi qeveritar është në shumë prej 8,657,741.00€, ndërsa të hyrat vetjake janë në shumë prej 2,439,993.00€. Në tabelën nr. 4 është paraqitur struktura e shpenzimeve në nivel të Kosovës, ndërsa në tabelën nr. 5 është e zbërthyer për secilën kategori ekonomike struktura e buxhetit të planifikuar si vijon: për kategorinë

ekonomike të pagave dhe mëditjeve për 751 punëtorë është shuma prej 4,853,001.00€, për mallra dhe shërbime 898,039.00€, për shpenzime komunale është shuma 200,000.00€, për subvencione dhe transfere është 390,000.00€, ndërsa shuma për investime kapitale, e paraqitur në tabelën nr. 6 është 4,756,694.00€. Ky është vetëm hapi i parë i hartimit të buxhetit i cili deri më datë 30 qershor duhet të dorëzohet në Ministrinë e Financave, ndërsa pas ardhjes së Qarkores së dytë Buxhetore do të bëhet finalizimi i Buxhetit për vitin 2019. Gjatë muajve korrik dhe gusht do t'i kemi tri dëgjime buxhetore.

Durim Hajra: Hartimi i këtij buxheti paraqet një shabllon me vitet paraprake, ku 44% e buxhetit është e paraparë për paga dhe mëditje, 8% për mallra dhe shërbime, ndërsa vetëm 43% shkon për projekte publike që shkojnë në interes të qytetarëve. Për 6 vite me radhë nuk bëhet ndërtimi i shkollës në Nakarad, i cili është i planifikuar të fillojë vetëm në vitin 2020-2021. Në anën tjetër janë të parapara 380 mijë euro për shtruarjen e rrugëve me zhavorr në momentin kur Ekzekutivi i Komunës ka thënë se është në përfundim edhe infrastruktura e asfaltimit të rrugëve! Për lagjen 'Dardania' nuk ka asnjë plan të fizibilitetit për ndonjë projekt publik. Komuna as në vitin e ardhshëm nuk planifikon të ndërtojë çerdhe, të pajis shkollat me laboratorë, ose të ndërtojë ndonjë park apo qendër sociale! Në Drejtorinë e Shëndetësisë dhe Mirëqenies Sociale parashihet ndërtimi i pesë punkteve të ambulancave të Mjekësisë Familjare, ndërsa në anën tjetër ato nuk mund të funksionalizohen për arsye të mungesës së personelit shëndetësor! Sa i përket ambientit nuk parashihet të ketë kënde të lojërave në lagjet e komuniteteve apo në lagjen më të dendur 'Dardania', ku po ashtu mungojnë parkingjet dhe shtigjet për çiklistë. Do të ishte e mirëseardhur që të mendohej edhe për krijimin e një tregu mobil. Në qoftë se këto kërkesa tona, të cilat do t'i dorëzojmë edhe në formën e shkruar para miratimit përfundimtar të buxhetit, nuk merren parasysh ne do të jemi kundër.

Eglantina Azemi: Edhe pse është marrë 'Vendim për sigurimin e mjeteve për blerjen e mamografit' ai nuk është i përfshirë në projeksionet buxhetore për vitin 2019. Në arsim kërkojmë që të bëhen vizita sistematike shëndetësore nëpër shkolla, në mënyrë që tek fëmijët të vërehet me kohë ndonjë anomali apo sëmundje. Po ashtu kërkojmë që të sigurohen shujtat për nxënësit nga klasa e parë deri në klasën e pestë duke e kontraktuar edhe ndonjë kuzhinë të caktuar, meqë ky ka qenë edhe premtim i Kryetarit të Komunës!

Doruntina Jashari: Në Drejtorinë e Arsimit ne propozojmë që të planifikohet ndërtimi edhe i një çerdheje tjetër publike sepse nevojat janë të mëdha. Po ashtu kërkojmë që të mendohet edhe për hapjen e klasave për parashkollorë sepse kjo parashihet edhe me nenin 9 dhe 10 të Ligjit për Arsim. Në fushën sociale dhe humane propozojmë që të ndërtohet një qendër sociale për personat e moshuar. Nëse nuk merren parasysh këto kërkesa tona ne jemi kundër aprovimit të këtij buxheti.

Bashkim Krasniqi: Ne kërkojmë që të ketë projekte të ndara për lagjet e komuniteteve sepse realiteti atje dallon nga pjesët tjera të qytetit, andaj ka nevojë që edhe për një kohë të caktuar të ketë investime më specifike për ta ndryshuar gjendjen. Në lagjet tona mungon çerdhja, disa rrugë janë asfaltuar por ka ende shumë rrugë të paasfaltuara. Është punuar edhe në ndërtimin e shtëpive, por mungon infrastruktura.

Driton Ademi: Unë këtu do ta paraqes pozicionin politik të Nismës Socialdemokrate lidhur me këtë konstrukt teknik të menaxhimit financiar strategjik ku parashihet zbatimi i aktiviteteve dhe përshkrimi i burimeve të financimit, mirëpo mungon analogjia për realizimin e projekteve që e kanë bazamentin në nevojat e komunitetit sepse komuna jonë, me buxhete të njëjta për shumë vite,

ka kaluar në procesin e rikuperimit dhe realizimit të projekteve të njëjta. Andaj, ne nuk mund të pajtohemi me këtë formë të hartimit dhe planifikimit të buxhetit!

Mehdi Lahu: Ndarja e buxhetit në arsim bëhet për kokë nxënësi, ndërsa ne e kemi një situatë ku kemi mungesë të kuadrove meqë nuk është bërë regjistrimi real i popullsisë, që kërkon shërbime publike në arsim dhe shëndetësi në komunën tonë, andaj ne do të kemi probleme edhe në periudhën e ardhshme në arsim dhe shëndetësi. Propozoj që të analizohen mundësitë buxhetore për ndërtimin edhe të një çerdheje publike dhe hapjen e klasave për parashkollorë.

Drejtori i Financave dhe Buxhetit: Ne në planifikimin e buxhetit nuk kemi ndarje. Investimet publike do të bëhen për të gjithë qytetarët, pa kurrfarë dallimi. Në programin komunal të investimeve publike parashihen projekte kapitale të cilat mund të ndryshohen me propozimet tuaja vetëm brenda kufijve të buxhetit.

Naser Graiçevci: Unë dua të paraqes para jush faktin se planifikimi i buxhetit nga komuna paraqet një stereotip ku 95% e tij është përsëritje e njëjtë, mungon kreativiteti! Po të kishte vetëm 30% ndryshim do të kishte zgjidhje të problemeve të grumbulluara të qytetarëve. Infrastruktura e ndërtuar me projekte 'ad-hoc' po shkatërrohet. Ekzekutivi i Komunës nuk ka asnjë planifikim për rregullimin e trafikut, ku ka shumë tollovi, edhe pse ne jemi një territor fushor. Nga fshati Graboc i Poshtëm deri në hyrje të Prishtinës mungojnë shtigjet për çiklistë, në tërë botën mendohet se si të përkrahen personat e moshuar dhe personat me aftësi të kufizuara, ndërsa në planifikimet tona buxhetore nuk ka asnjë projekt të tillë! Në ndarjet buxhetore ka një disbalanc të shpërndarjes së parasë publike, shpenzimet për projekte kapitale në bujqësi janë zero, ndërsa në asfalte qindra, mijëra euro! Ne kemi propozuar, sa unë kam qenë në Partinë Demokratike të Kosovës, që të mendohet në përkrahjen e projekteve të fermerëve tanë për ruajtjen e produkteve të tyre për më shumë se 30 ditë duke krijuar deponi për ruajtjen e tyre edhe përmes programeve të partneritetit publiko-privat. Po ashtu kemi kërkuar që ta kemi një administratë moderne të digjitalizuar dhe ne të informohemi me dokumentacionin për shqyrtim përmes email-adresave tona.

Ali Ismaili: Shumica e çështjeve për të cilat unë dua të diskutoj u parashtruan nga parafolësit e mi. Të gjitha këto çështje ne i kemi parashtruar si subjekt politik edhe në katër vitet e kaluara, e kemi ngritur zërin por vendimet janë marrë me shumicë të votave nga ana e partisë në pushtet, andaj nuk ka pasur mundësi të bëhen ndryshime substanciale! Kemi përsëritje të projekteve të njëjta, ndërtim të sallave, në vend se të merremi me mirëmbajtjen e tyre, blerje të pajisjeve kabinetike, mirëpo jo përmirësim të gjendjes në arsim, shëndetësi, apo fusha tjera! Thuhet se mund të ketë ndryshime gjatë debateve publike por një vend, ku edhe 20 vjet pas luftës, për shkak të gjendjes së rëndë ekonomiko – sociale, njerëzit mund të mashtrohen e manipulohen me miell e vaj para zgjedhjeve, kjo paraqet një tmerr dhe ndryshimi i gjendjes nuk mund të bëhet! Kjo gjendje e rëndë vjen si rezultat edhe i mosfunksionimit të prokurorisë së shtetit, edhe përkundër ngritjes së çështjeve të caktuara! Parashihen 400 mijë euro për bashkëfinancim me Drejtorinë e Financave, të cilat me siguri janë të dedikuara për vazhdimin e projektit të KARITAS-it, mirëpo pa asnjë specifikim se si do të shpenzohen! Po ashtu 35 mijë euro parashihen për subvencione në Drejtorinë e Financave dhe Buxhetit! Pyes, për çka i duhen kësaj drejtorie subvencionet?

Aida Alimi: Edhe unë dua t'i bashkëngjitem mendimeve të parafolësve lidhur me buxhetin sepse planifikimi i buxhetit nuk ka asnjë ndryshim dhe paraqet një kopjim të projekteve ku çdo herë ka shuma të përafërta të asfaltimeve të ndërtimit e renovimit të shtëpive dhe asnjë projekt të ri konkret që do të kishte ndikim në përmirësimin e jetës së qytetarëve!

Nënkryetari Komunës: Buxheti i planifikuar për vitin 2019 është bërë në bazë të kërkesave të dorëzuara prej qytetarëve nëpër drejtoritë e komunës. Subvencionimi në bujqësi bëhet në bashkëfinancim me fermerët në tri vitet e fundit. Kjo formë e zhvillimit po përkrahet nga shumica e qytetarëve, mirëpo ne jemi të hapur që t'i analizojmë propozimet e juaja dhe të qytetarëve për ndryshimin e ndonjë projekti të caktuar.

Mehdi Lahu: Ndriçimi publik ka dështuar andaj ne kërkojmë që të ndahet një shumë e caktuar e buxhetit për aktivizimin dhe funksionimin e këtij investimi të bërë publik.

Betim Ahmeti: Në Rrugën '17 Shkurti' jeton familja 'Behluli' e cila i ka tre anëtarë të vrarë nga forcat serbe, është kërkesë e tyre që në pronën e tyre të vendoset një përmendore dhe hapësira përreth në atë zonë të jetë si park për qytetarët e Komunës së Fushë-Kosovës. Andaj, ne kërkojmë që të ndahet një shumë e mjeteve financiare për këtë qëllim.

Remzi Shala: Ne kërkojmë që ky buxhet i planifikuar nga Ekzekutivi i Komunës, që ka një gjithëpërfshirje, duke vendosur projekte të investimeve publike për secilën lagje dhe fshat, të aprovohet. I njëjti ka mundësi që të plotësohet me propozime të reja gjatë dëgjimeve publike. Nevoja për ndërtimet e ambulancave të Mjekësisë Familjare ekziston në pikëpamjen e rregullimit të hapësirës së tyre në mënyrë që ato të jenë funksionale.

Pas sqarimeve, Kryesuesja e Kuvendit të Komunës e qiti në votim 'Propozimin për aprovimin e Kornizës Afatmesme Buxhetore 2019-2021'.

U votua me: trembëdhjetë vota 'për', pesë 'kundër' dhe tri abstenime, gjithsej njëzet e një anëtarë.

Në bazë të votimit, Kryesuesja e Kuvendit të Komunës konstatoi se Kuvendi i Komunës, me shumicë të votave, e aprovoi 'Propozimin për aprovimin e Kornizës Afatmesme Buxhetore 2019-2021' dhe mori:

V E N D I M

1. Për aprovimin e Kornizës Afatmesme Buxhetore Komunale 2019-2021, me kufijtë e caktuar si vijon:

1.1 Për vitin 2019 buxheti i komunës është në shumë prej 11,097,734.00€;

1.2 Për vitin 2020 buxheti i komunës është në shumë prej 11,466,733.00€;

1.3 Për vitin 2021 buxheti i komunës është në shumë prej 11,857,033.00€.

Pika e tretë (3) - Propozim për lejin e shfrytëzimit të mjeteve financiare për zhvillimin e mësimi joformal.

Kryesuesja e Kuvendit të Komunës: E kemi për shqyrtim 'Propozimin e Drejtorisë së Arsimit për pagesën e mësimdhënësve që e zhvillojnë mësimin joformal'. Ftoj Drejtorin e Arsimit që të na jap sqarime.

Drejtori i Arsimit: Mësimi joformal zhvillohet për personat e rritur të cilët e kanë kaluar moshën 18 vjeçare dhe për arsye të ndryshme nuk e kanë kryer shkollën e mesme. Ky mësim zhvillohet vetëm në Shkollat Profesionale, në drejtimet ekonomike dhe teknike. Këtë vit i kemi 120 kandidatë, ata participojnë me 150 euro. Transferimi i këtyre mjeteve bëhet për arsye se shkolla nuk ka gjirolligari të veten. Shuma prej 12 799 eurove, ose 65% e këtyre mjeteve, shpenzohen për paga dhe mëditje, ndërsa pjesa tjetër për mallra dhe shërbime.

Driton Ademi: Propozimi për ndarjen e këtyre mjeteve është për tri shkolla dhe nuk është i artikuluar si duhet, kemi dyfishim në përmbajtjen e tij! Duhet të qartësohen drejtimit përkatëse: ekonomik, juridik dhe teknik si dhe të shkruhet baza ligjore e Ligjit për Vetëqeverisje Lokale dhe Ligjit për Menaxhimin e Financave Publike, sepse kjo nuk figuron askund!

Drejtori i Arsimit: Sqaroj se përveç personelit mësimdhënës paguhen edhe: drejtori, sekretari dhe stafi administrativ.

Bashkim Krasniqi: Pyes, a ka lirime nga kjo pagesë prej 150 eurove për komunitetet rom, ashkalinj dhe egjiptian?

Drejtori i Arsimit: Sqaroj se këtë vit e kemi liruar vetëm një kandidat, ndërsa më herët kemi pasur raste kur janë liruar edhe deri në 10 kandidatë.

Remzi Shala: Mësimi joformal është i lejuar me Ligj dhe Udhëzim Administrativ. Grupi Parlamentar i Lidhjes Demokratike të Kosovës e përkrah këtë propozim për aprovim.

Bashkim Krasniqi: Unë dua ta pyes Drejtorin e Arsimit se në sa raste janë përkrahur studentët nga radhët e komuniteteve?

Drejtori i Arsimit: Zakonisht ne i përkrahim mbi 100 studentë në vit dhe në mesin e tyre janë edhe 5 apo 6 studentë nga radhët e komuniteteve.

Mehdi Lahu: Ne duhet ta kemi listën e përfituesve të subvencioneve dhe t'i dimë paraprakisht kriteret në bazë të të cilave vendoset për ndarjen e bursave për studentë.

Drejtori i Arsimit: Unë nuk vendos vetë për këtë çështje, për ndarjen e bursave vendos Komisioni ku për bazë merret nota mesatare.

Pasi që diskutime tjera nuk pati, Kryesuesja e Kuvendit të Komunës e qiti në votim 'Propozimin për lejimin e shfrytëzimit të mjeteve financiare për zhvillimin e mësimi joformal'.

U votua me: shtatëmbëdhjetë vota 'për', asnjë 'kundër' dhe një abstenim, gjithsej tetëmbëdhjetë anëtarë.

Në bazë të votimit, Kryesuesja e Kuvendit të Komunës konstatoi se Kuvendi i Komunës, me shumicë të votave, e aprovoi 'Propozimin për lejimin e shfrytëzimit të mjeteve financiare për zhvillimin e mësimi joformal' dhe mori:

V E N D I M

1. Aprovohet propozimi për hapjen e linjës buxhetore në kategorinë ekonomike 11 për 'Rroga dhe paga'.
2. Mjetet financiare, në shumë të përgjithshme prej 12,779.72€, si të hyra vetjake në arsim, destinohen për pagesat e arsimtarëve dhe stafit arsimor që kanë zhvilluar dhe zhvillojnë procesin mësimor mbajtjen e provimeve nga mësimi joformal dhe alokohen në kategorinë ekonomike 11 në arsimin e mesëm si vijon: në arsim të mesëm për Shkollën e Mesme Teknike 'Minatori', kodi i programit Nr. 94231, shuma 3,236.89€, në arsim të mesëm për Shkollën e Mesme Ekonomike 'Hoxhë Kadri Prishtina', kodi i programit Nr. 94232, shuma 4,267.01€ dhe në arsim të mesëm për Shkollën e Mesme 'Hivzi Sulejmani', kodi i programit Nr. 94233, shuma 5,275.82€.

Pika e katërt (4) - Propozim për riorganizimin e mësimi në shkollat fillore në Fushë-Kosovë.
Kryesuesja e Kuvendit të Komunës: E kemi për shqyrtim 'Propozimin për riorganizimin e mësimi në shkollat e qytetit të Fushë-Kosovës', për arsye se në qytetin tonë kemi migrim dhe ardhje të nxënësve nga e tërë Kosova. Ftoj Drejtorin e Arsimit që të na jap sqarime.

Drejtori i Arsimit: Të gjithë ju e dini se Shkolla Fillore e Mesme e Ulët 'Mihal Grameno' në Fushë-Kosovë është e ngarkuar dhe përbëhet nga 20 klasë. Numri i nxënësve nëpër klasa është mbi 40. Tani atje numri i përgjithshëm i nxënësve ka arritur në 2446 nxënës, presim që në shtator të shtohen edhe 300 nxënës të rinj, andaj jemi të detyruar që nxënësit nga klasa e 6-të deri në klasën e 9-të, gjithsej 25 paralele, të barten në shkollën e re 'Daut Bogujevci' në Fushë-Kosovë, për një kohë të përkohshme, deri në ndërtimin e shkollës së re në 'Kompleksin 300'. Në Bresje priten të vijnë 943 nxënës, ndërsa atje do të mbesin 1500 nxënës.

Aida Alimi: Këto probleme i kemi tani në arsim meqë pushteti aktual nuk ka përcaktuar dhe zbatuar politika për regjistrimin e banorëve të rinj që kanë migruar në komunën tonë. Unë mendoj se do të kemi probleme pasi që këtë punë nuk do ta pranojnë prindërit e nxënësve, andaj ne jemi kundër sepse kërkesat tona nuk janë marrë parasysh me kohë.

Driton Ademi: Kjo gjendje është për shkak të politikave të gabuara, keqpërdorimit të investimeve publike dhe bërjes së zgjidhjeve të përkohshme 'ad-hoc'! Drejtoria e Arsimit duhet të mendojë me kohë për zgjidhjen këtyre problemeve dhe menaxhim adekuat - zgjerimin e kapaciteteve teknologjike si dhe duhet të ketë një qasje insistuese për zbatimin e programeve të reja.

Doruntina Jashari: Lagjia 'Dardania' është shumë e ngarkuar dhe infrastruktura atje nuk pritet të përfundojë edhe për tri apo më shumë vite. Në anën tjetër komuna i bartë nga dy milionë euro të pashpenzuara nga viti në vit dhe tani kërkon që të barten nga lagjia 'Apollonia' dhe 'Dardania' në Bresje mbi 1 000 nxënës, të cilët do të rrezikohen! Kjo vjen si rezultat i keqmenaxhimit në arsim! Ne mendojmë se do të ishte më mirë që ndarja të bëhet sipas lagjeve dhe nxënësit mos ta kalojnë rrugën kryesore.

Arjeta Jashari: Në emër të Grupit Parlamentar të Lidhjes Demokratike të Kosovës ne e përkrahim 'Propozimin për riorganizimin e procesit mësimor' meqë nuk kemi mundësi që tani për tani të kemi zgjidhje tjetër.

Drejtori i Arsimit: Vendosja e nxënësve në shkollë është obligim ligjor dhe human. Ne i kemi menduar të gjitha variantet dhe kemi ardhur në përfundim se zgjidhja më e mirë është që nxënësit nga klasa e gjashtë deri në klasën e nëntë të vijnë në shkollën 'Daut Bogujevci' në Fushë-Kosovë. Prandaj, ju ftojme juve, si anëtarë të Kuvendit, që ta përkrahni këtë propozim për riorganizimin e procesit mësimor. Infrastruktura e ndërtimit është zhvilluar shumë, por kjo nuk është përcjellë sa duhet me rregullimin e infrastrukturës në arsim dhe shëndetësi, dhe si shkak i migrimeve të qytetarëve nga viset tjera ne i kemi këto probleme. Mendoj se kjo zgjidhje do të jetë për një kohë të shkurtër kohore deri në ndërtimin e shkollës së re.

Pas sqarimeve Kryesuesja e Kuvendit të Komunës e qiti në votim 'Propozimin për riorganizimin e mësimit në shkollat fillore në Fushë-Kosovë'.

U votua me: njëmbëdhjetë vota 'për', katër 'kundër' dhe një abstenim, gjithsej gjashtëmbëdhjetë anëtarë.

Në bazë të votimit, Kryesuesja e Kuvendit të Komunës konstatoi se Kuvendi i Komunës, me shumicë të votave, e aprovoi 'Propozimin për riorganizimin e mësimit në shkollat fillore në Fushë-Kosovë' dhe mori:

V E N D I M

1. Për aprovimin e Propozimit Nr. 491, të datës 20.06.2018, për riorganizimin e procesit mësimor në Shkollën Fillore të Mesme të Ulët 'Mihal Grameno' në Fushë-Kosovë për shkak të numrit të madh të nxënësve, si vijon:


- 1.1 Nxënësit e klasave të para, dyta, treta, katërta dhe të pesta procesin edukativo-arsimor do ta zhvillojnë në objektin e shkollës 'Mihal Grameno' në Rrugën 'Nënë Tereza' në Fushë-Kosovë;
- 1.2 Nxënësit e klasave të gjashta, shtata, teta dhe të nënta procesin edukativo-arsimor do ta zhvillojnë në hapësirat e objektit të ri shkollor 'Daut Bogojevci', në Rrugën 'Tahir Zemaj' në Fushë-Kosovë deri në ndërtimin e objektit të ri shkollor në Rrugën 'Shefki Kuleta', afër Kompleksit 300 të ndërtesave.

Pika e pestë (5) - Të ndryshme.

Kryesuesja e Kuvendit të Komunës: E kemi pikën 'Të ndryshme', ftoj anëtarët e Kuvendit të Komunës që ta marrin fjalën, nëse kanë ndonjë çështje për diskutim.

Kryesuesja e Kuvendit të Komunës falënderoi të pranishmit për pjesëmarrje në mbledhje.
Mbledhja përfundoi në orën 13:00h.

Procesmbajtës
Hasan Gjyrevci



Kryesuesja e Kuvendit të Komunës
Vjollca Konjusha

